



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.551/2025

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtaret: Bujar Muzaqi kryesues, Hajriz Hoti dhe Violeta Husaj Rugova anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) - Nisma Socialdemokrate (Nisma), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 13.02.2025, merr këtë :

#### V E N D I M

**HEDHEN TË PASAFATSHME** ankesat Anr.551/2025, dhe Anr.553/2025 të datës 10.02.2025, e parashtruar nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, parashtruar kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) - Nisma Socialdemokrate (Nisma), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09 Shkurt 2025.

#### A r s y e t i m

Me datë 10.02.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesën Anr.551/2025 të datës 10.02.2025 nga subjekti politik LVV me të cilën pretendon se datë më 09 shkurt 2025, qendra e Lëvizjes Vetëvendosje në Prishtinë, gjatë monitorimit të tubimeve politike dhe fushatës zgjedhore, ka vërejtur gjuhë denigruese dhe fyese nga kandidati i koalicionit AAK-Nisma, z. Fatmir Limaj në tubimin e mbajtur në Pejë me datë 08.02.2025, duke përdorur fjalinë "*Albin Kurti dëshiron ta kap shtetin.*", dhe bën krahasimin me një politikan Rus, konkretisht diktatorin Leninin dhe e quan "*Lenini i Vogël*" të cilët njihen për qëndrime antishtetërore ndaj Republikës së Kosovës dhe qëndrime autoritare përfshirë gjenocide në njerëz, përgjegjës për dhunën ndaj kundërshtarëve politikë etj. Parashtruesi i ankesës thekson qëllimi i deklaratës së z. Limaj ka për qëllim denigrimin e figurës së Kryeministrit z. Albin Kurti, kështu duke nxitur qytetarët kundër Lëvizjes Vetëvendosje dhe duke e fyer Kryeministrin e vendit z. Albin Kurti. Me këtë veprim sipas parashtruesit të ankesës koalicioni politik AAK-Nisma kanë bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.11, të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës LZP, me çka ka përdorur gjuhë denigruese, dhe ka nxitur qytetarët

kundër Lëvizjes Vetëvendosje. Andaj të njëjtit kërkohet që masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjislacionin në fuqi. Si provë ka bashkangjitur një CD.

Me datë 10.02.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesën Anr.553/2025 me të cilën pretendon se më datë 09 shkurt 2025, qendra e Lëvizjes Vetëvendosje në Komuna Prishtinë, gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore, ka vërejtur gjuhe fyese, dhe denigruese nga kandidati për deputet i radhëve të koalicionit AAK-Nisma, z. Fatmir Limaj gjatë tubimit të mbajtur në Pejë me datë 08.02.2025 ku e quan Kryeministrin z. Albin Kurti me fjalët “*Urrejtës, shpifës e mashtrues*”. me çka ka rënë ndesh me nenin 34 par 1 nën par 1.11 të LZP-së. Si provë ka bashkangjitur një CD.

Sipas parashtruesit të ankesës përmes këtij veprimi, subjekti përkatës, ka cenuar dispozitat përkatëse ligjore, andaj duke u mbështetur në bazën ligjore dhe argumentet e lartcekura, kërkohet që masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur nga koalicioni AAK - Nisma theksohet se tubimi është mbajtur me datë 08.02.2025 në ora 13:30, ndërsa ankesa është dorëzuar në PZAP me datë 10.02.2025 në ora 17:00, pra e njëjta është pasafatshme. Për të vërtetuar këtë fakt në fotografinë e mëposhtme vërtetohet që tubimi është mbajtur me datë 08.02.2025, nga ora 13:30. Në Nenin 39, par. 3 të LZP në mënyrë decisive thuhet se: *"Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it [...] mund të paraqesë ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar..."*.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr. 01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosies së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi I të Ligjit Nr. 05/1,-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ankesat e evidentuara me numrat si në vijim : Anr.551/2025, dhe Anr.553/2025 të datës 10.02.2025, janë bashkuar dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët Anr.551/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara kundër subjektit të njëjtë politik AAK-Nisma për shkeljen e njëjtë, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e parashtruara të ankesave.

Paneli pas vlerësimit të afatshmërisë së ankesave, gjeti se :

***-Ankesat janë të pasafatshme.***

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të ankesave, ka gjetur se ankesat e parashtruara nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, parashtruar kundër subjektit politik AAK - Nisma, janë të parashtruara pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 39 paragrafi 3 i LZP-së, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se : *"Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilin janë shkelur për sa i përket shkeljeve të pretenduara të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët gjatë periudhës së fushatës zgjedhore dhe ditës së zgjedhjeve, mund të paraqes ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar, dhe PZAP-i, do të vendos për ankesën brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve nga koha e pranimit të saj"*, si dhe në nenin 13, paragrafi 3, nën paragraf 3.3 të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosies së Ankesave të PZAP-it, në mënyrë decisive thuhet se *"PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim"*, ndërsa në nenin 13 par.3 nënparagrafi 3.3. thuhet se *"nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor"*.

Në këtë rast, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, konstatohet se parashtruesi i ankesave ka dorëzuar ankesën në PZAP, më datë 10.02.2025 në ora 17:00, ku ka pretenduar se subjekti politik AAK-Nisma është përgjegjës për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09.02.2025.

Megjithatë, ankesat janë parashtruar pas afatit ligjor për paraqitjen e tyre, sipas nenit 39, paragrafi 3 i LZP-së, ku afati për dorëzimin e ankesës është 48 orë nga ndodhja e shkeljes së supozuar, ndërkohë tubimi përmbyllës në Pejë i subjektit politik AAK - Nisma ka ndodhur me datën 08.02.2025 në ora 13:30, ndërsa ankesat janë dorëzuar në PZAP më datën 10.02.2025 në ora 17:00, që do të thotë se ankesat janë dorëzuar pas afatit të paraparë ligjor.

Paneli gjeti se të njëjtat janë ushtruar pas afatit ligjor, dhe nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 39 paragrafi 3, nenit 115 paragraf 1 i LZP-së, dhe nenit 9 paragrafi 5 nen paragrafi 5.5 të Rregullës 01/2025, për Procedurat e Parashtrimin dhe Vendosjes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**

Anr.551/2025 datë 13.02.2025

**Kryesues i Panelit,**

**Bujar Muzaqi**



***KËSHILLA JURIDIKE:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimin të këtij vendimi.